



## BASHKIA TROPOJE

### KONTRATE

#### MBIKQYRES PUNIMESH

Sot ne daten 28/07/2017 nenshkruhet kjo Kontrate realizimin e objektit: "MBIKQYRJE PUNIMESH " ndermjet paleve:

- BASHKIA TROPOJE, qe me poshte do te emertohet *Bleresi*, perfaqesuar nga Besnik DUSHAJ, Kryetar i ketij Institucioni.
- Z.Gazmir Bizhga perfaqesues i GB Civil Engineering sh.p.k me Nipt L51825011V me licence MK.2812,qe me poshte do te quhet mbikqyres i punimeve.

*Perfaqesuesit e paleve te cilesuar si me siper ne kete kontrate, deklarojne me vullnetin e tyre te lire se lidhin kete kontrate me kushtet qe vijojne:*

#### Neni 1. Objekti

Objekt i kesaj Kontrate do te jete Supervizim objekti Rikualifikim i fasadave te objekteve, qyteti Bajram Curri.

Vlera e kontrates : 373 707,6 leke pa tvsh + 74 741,52 leke tvsh = 448 449,12 (katerqindedyzetetetmije e katerqindedyzetenente )leke me tvsh

#### Neni 2. Baza ligjore :

Kjo kontrate bazohet ne Ligji 8402 dt 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" I ndryshuar dhe ne baze te Udhëzimit Nr 3 dt 15.02.2001 i ndryshuar te Keshillit te Ministrave "PËR MIRATIMIN E MANU-ALIT TË TARIFAVE PËR SHËRBIME NË PLANIFIKIM TERRITORI, PROJEKTIM, MBIKËQYRJE DHE KOLAUDIM" dhe V.K.M, nr.354,dt.11.05.2016" **Per miratimin e manualit te tarifave per sherbime ne planifikim territori, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim**

#### Neni 3 Detyrimet e mbikqyresit

Mbikqyresi i punimeve ka per detyre te ndjeke zbatimin me korrektesi te kontrates se lidhur midis investitorit dhe sipermarresit, dt.06.7.2017 me vlere **35 093 588** leke me tvsh .

Mbikqyrsi i punimeve kontrollon situacionin dhe pasi e miraton ate e kalon per likujdim.

Mbikqyrsi i punimeve kontrollon dhe autorizon perdorimin e fondit rezerve te objektit.

Mbikqyrsi i punimeve asiston ne kualidimin e objektit dhe firmos p.v e koalidimit.

mbikqyresi i punimeve ka te drejte qe te kerkoje verifikime te materialeve dhe paisieve ,si dhe te kerkoje te behen prova te ndryshme n.q.s ai shikon te arsyeshme.

Kerkon nga firma sipermarrese zbatimin e projektit,cilesine dhe perdorimin e materialeve sipas kushteve teknike

Kerkon nga sipermarresi mbajtjen e dokumentacionit,librezat e masave,pasqyrat e volumeve,proces verbalet e punimeve te maskuara te cilat duhet te kryhen vetem pas miratimit me shkrim nga drejtuesi i punimeve.

#### **Neni 4 Pagesat**

Per punen e kryer mbikqyresi i punimeve do te paguhet nga investitori me shumen e llogaritur ne baze te V.K.M, nr.354,dt.11.05.2016" PËR MIRATIMIN E MANUALIT TË TARIFAVE PËR SHËRBIME NË PLANIFIKIM TERRITORI, PROJEKTIM, MBIKËQYRJE DHE KOLAUDIM", ne numrin e llogarise te Supervizorit (Mbikqyresit te punimeve) Nr.llogarise : \_\_\_\_\_.

Ndarja e kesaje shume ndermjet mbikqyresve do te behet sipas nje marveshje te vecante ndermjet tyre. Pagesa e mbikqyresit do te behet ne perpjestim me vleren e realizuar ne objekt ( Vleren e Situacionuar ).

#### **Neni 5 detyrat e Investitorit**

Investitori do ti dorezoje nje kopie drejtuesit te punimeve te dokumentacionit qe ka ne lidhje me firmen sipermarrese te punimeve qe eshte firma " B.O Ergi shpk K02727229P & Vellezerit Hysa shpk K12911201C

" licensat ,preventivat,grafiqet,kontratat e lidhura midis investitorit dhe firmes,katallogjet e paraqitura etj.

#### **Neni 6 Afati**

Kohezgjatja e kesaje kontrate eshte deri ne perfundimin e punimeve te ndertimit dhe kolaudimit te objektit.

Mbikqyresi i punimeve mban pergjegjesi per shkeljen e kontrates dhe te dispozitave ligjore ne fuqi dhe ndaj tije aplikohen sanksionet qe permban Ligji 8402 dt 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar

Mosmarreveshjet midis paleve nese nuk zgjidhen me mirekuptim do ti drejtohen Gjykates se Rrethit Tropoje.

Kjo kontrate eshte pergatitur ne kater kopje dhe ne gjuhen shqipe. Pasi u lexua nga te dy palet, u nenshkrua me vullnet te lire. Sejcila pale merr nga dy kopje.

Per Bashkine Tropoje

Besnik DUSHAJ



Mbikqyresi i Punimeve

GB Civil Engineering sh.p.k

